



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Formulari nr. 3

[Datë 24.09.2021]

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Tiranë
Adresa	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Tel/Fax	0035542256799
E-mail	administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit	www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 4 (katër) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë – Kiev – Romë – Gjeorgji - Tiranë”**.

Data e zhvillimit do të jetë **24.09.2021 ora 19:20** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

1. Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Kiev- Romë - Gjeorgji - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë – Kiev- Romë - Gjeorgji -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Kiev do të bëhet në datë 27.09.2021 pasdite pas orës 19.00 dhe mbërritja në Kiev në darkë. Pa ndalesë.
- Nisja nga Kiev në Romë do të bëhet në datë 29.09.2021 paradite, mbërritja në Romë para orës 13.00. Pa ndalesë.
- Nisja nga Roma në Gjeorgji do të bëhet në datë 29.09.2021 mbasdite pas orës 19.00, mbërritja në Gjeorgji më datë 30.09.2021 para orës 06.00. Me një ndalesë.
- Kthimi nga Gjeorgjia në Tiranë do të bëhet në datë 03.10.2021 në drekë, nisja nga Gjeorgjia në mëngjes dhe mbërritja në Tiranë në drekë para orës 13.00. Me një ndalesë.
- Bagazhe të përfshira

2. Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Kiev- Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë – Kiev- Tiranë

- Nisja nga Tirana drejt Kiev do të bëhet në datë 27.09.2021 pasdite dhe mbërritja në Kiev në darkë.
- Kthimi nga Kiev në Tiranë do të bëhet në datën 29.09.2021 pasdite. Nisja nga Kiev pasdreke dhe mbërritja në Tiranë pasdite para orës 19.00.
- Pa ndalesë. Bagazhe të përfshira

3. Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Gjeorgji - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë – Gjeorgji -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt drejt Gjeorgjisë do të bëhet në datë 30.09.2021 në drekë pas orës 15.00 dhe mbërritja në Gjeorgji në mesnatë para orës 01.00 me orën lokale. Me një ndalesë jo më gjatë se 2.30 orë.
- Kthimi nga Gjeorgjia në Tiranë do të bëhet në datë 03.10.2021 në drekë, nisja nga Gjeorgjia në mëngjes dhe mbërritja në Tiranë në drekë para orës 13.00. Me një ndalesë.
- Bagazhe të përfshira

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

a) Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: administrative.prokurime@tirana.al) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.